



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
OSNOVNI SUD U PRIŠTINI – BASIC COURT OF PRISTINA



DEGA NË LIPJAN-OGRAK LIPLJANE

**P.nr.307/18**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË–DEGA NË LIPJAN**, nga gjyqtari Avdirrahman Gashi me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nexhmije Ahmeti, në çështjen penale ndaj të pandehurit B. R. nga fsh.R. K.L., të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.5381/17 të dt.21.05.2018, për shkak të veprës penale Ngacmimi nga neni 186 par.1 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur me dt.11.10.2018, në prezencën e prokurorit të shteti M. L., dhe të pandehurit B. R., në të njëjtën datë merr dhe publikisht shpallë këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Ndaj të pandehurit:**

B. R., nga i ati P., dhe e ëma Xh. e gjinis D., i lindur me dt. *data e lindjes...*, ne fshatin R. K.L., ku edhe jeton, me nr. personal *numri përsonal...*, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri,

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**Sepse:**

Me datë 28.08.2017, rreth orës 19.10, në fshatin R. Komuna L., i pandehuri B. R. , pas mosmarrëveshjeve dhe ngacmimeve edhe të mëparshme lidhur me një pronë ndaj të dëmtuares S. R. gruaja e axhes së tij, ditën kritike e ka pritur kur e dëmtuara ka ardhur nga puna dhe ka thënë se do ta vendosi një gyp të kanalizimit nëpër rrugën pronë e të dëmtuares, dhe i ka thënë se kam prit derisa të vdes axha dhe tash ty ka me të kap për flokë dhe ka me te qitë jasht oborrit dhe do ta marr token unë, me ç’rast tek e dëmtuara ka shkaktuar shqetësim te madh emocion dhe frik.

Me këtë ka kryer veprën penale Ngacmimi nga neni 186 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në baze të neneve, 1, 2, 4, 6, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 73, 186 par. 1 të KPRK-se, dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon me,

**DËNIM ME GJOBË**

Në shumë prej **200 (dyqind euro)**, të cilin dënim i pandehuri detyrohet ta paguaj në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë konform nenit 46 par 3 të KPRK-së, do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku për një ditë burgimi do ti llogaritet shuma prej 20-€.

**DETYROHET** i pandehuri që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të shpenzimeve të procedurës penale për paushall gjyqësor t’ia paguaj shumën prej 20-€, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj, PP.II.nr.5381/17 të dt.21.05.2018, e ka akuzuar të pandehurin B. R., për shkak të veprës penale penale Ngacmimi nga neni 186 par.1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar përfaqësuesi i Prokurorisë ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës dhe është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit nga se pranimi i tillë është i mbështetur në dispozitat ligjore, dhe në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe në të njëjtën kohë gjykatës i ka propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënosi sipas ligjit, si dhe me rastin e matjes së dënimit kësaj gjykate i ka propozuar që si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë nga i pandehuri.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar, pasi që e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, i njëjti e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, për veprën penale për të cilën akuzohet, dhe ka shtuar se e ndien veten fajtor për veprën penale dhe se është mbajtes i familjes dhe është hera e parë që ka rënë ndesh me Ligjin dhe i premtton gjykates në të ardhmen nuk do të perseris sjellje të tilla andaj propozon gjykatës që me rastin e matjes së dënimit të njëjtit ti shqiptohet një dënim sa më butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK së gjykata e pranoi pranimin e fajësisë të pandehurit, për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të pandehurin, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi sjelljen e mëparshme të kryerësit, pra fakti se i njëjti për here te pare ka rene ne kundërshtim me ligjin, rrethanat personale, se i njëjti është mbajtës i familjes, premtimin e dhënë kësaj gjykate se në të ardhmen nuk do ta përsërisë veprën penale apo të ngjashme, e veçanërisht pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, e në mungesë të rrethanave rënduese, konform nenit 73 të KPRK-së, të njëjtit i shqiptoi, dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 41 të KPRK-së, e cila dispozitë ka për qëllim që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e bazoi në nenin 450 par. 2 pika 2.6 të KPPK-së.

Lidhur me kërkesen pasuroro juridike gjykata nuk vendosi për arsye se e dëmtuara konforme nenit 461 të KPPK-së, heqi dore nga e njëjta.

Nga të gjitha arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN**

**P.nr.307/18, me dt.11.10.2018.**

**Zurtarja ligjore**  
Nexhmije Ahmeti

**GJYQTARI**  
Avdirrahman Gashi

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së të njëjtit. Ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate.